



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**  
**KRYETARI**

**Mbi raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për Kolegjin e Posaçëm të Apelit, për periudhën janar - gusht 2018**

Në zbatim të pikave 2 dhe 3, të nenit 19, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) i ka parashtruar Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dokumentin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit për KPA-në për periudhën janar - gusht 2018, miratuar me vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve datë 27.09.2018.

Kolegji i Apelit e ka përgatitur këtë raport monitorimi në zbatim të kërkesave ligjore, bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", ligjit nr. 109, datë 30.11.2017 "Për Buxhetin e vitit 2018", pikës 101 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018.

Monitorimi është proces vlerësimi i performancës institucionale dhe një nga 5 komponentët e kontrollit të brendshëm. Realizimi i treguesve buxhetorë për 8/ mujorin e vitit 2018 (janar-gusht), shërben si bazë për një analizë krahasimore plan-fakt të zërave të shpenzimeve për periudhën raportuese dhe jo më gjerë, pasi Kolegji i Posaçëm i Apelit është institucion i ri pa historik apo të dhëna statistikore ndër vite.

Buxheti i Kolegjit të Apelit për vitin 2018, është miratuar si pjesë e buxhetit të shtetit me ligjin nr.109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, i cili u rishikua në mbështetje të aktit normativ nr.1, datë 26.07.2018 (përcjellë pranë institucionit tonë me shkresën 14250/3, datë 31.07.2018).


Detajimi i buxhetit të vitit 2018 për shpenzimet korente dhe shpenzimet kapitale paraqitet në pasqyrën e mëposhtme.

000/lekë

Kodi i institucionit	Programi	Llogaria ekonomike	Buxheti vjetor 2018	Emërtimi	Pesha specifike e çdo zëri kundrejt buxhetit vjetor
1063003	03340	6000000	90,000	Pagat	62%
1063003	03340	6010000	8,000	Kontributi i sigurimeve shoqërore	6%
1063003	03340	6020000	20,000	Mallra dhe shërbime	14%

1063003	03340	2319999	26,000	Shpenzime kapitale	18%
<b>TOTALI</b>					<b>100%</b>
			<b>144,000</b>		

Pesha specifike e secilës llogari ekonomike mbi buxhetin total të miratuar me ligjin vjetor të buxhetit paraqitet edhe në mënyrë grafike si më poshtë:



Në kuadër të monitorimit për periudhën janar-gusht po analizojmë **realizimin e shpenzimeve korente** (paga, sigurime shoqërore, blerje mallra shërbime).

Fondi vjetor i miratuar për shpenzime korrente është 118,000 në mijë lekë. Plani për periudhën 8/mujore është 79,133 në mijë lekë dhe realizimi paraqitet si më poshtë.

**000/lekë**

Programi	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Plani vjetor	Plani 8-mujor	Realizimi 8-mujor	% realizimit
03340	6000000	Paga	90,000	60,000	50,077	<b>83%</b>
03340	6010000	Kontributi i shoqërore dhe shëndetësore	8,000	5,3333	3,814	<b>72 %</b>
03340	6020000	Mallra e shërbime	20,000	13,800	4,826	<b>35%</b>
		<b>TOTAL</b>	<b>118,000</b>	<b>79,133</b>	<b>58,717</b>	

## **I - Shpenzimet për paga (llogaria ekonomike 600)**

Fondi i miratuar për paga, përbën 62% të buxhetit vjetor të miratuar me ligj për vitin 2018. Realizimi i fondit të pagave si 8/mujor, kundrejt planifikimit të së njëjtës periudhë, është 83%. Realizimi në këtë masë është kryesisht rrjedhojë e mosplotësimit që në muajin janar 2018, të strukturës organike të Kolegjit të Apelimit. Nga muaji qershor 2017 dhe deri në fund të vitit 2017 u emëruan dhe filluan punë Gjyqtarët, Sekretari i Përgjithshëm dhe Sekretari i Kryetares gjithsej 9, nga 37 punonjës të miratuar në strukturë. Në 8/mujorin e vitit 2018 rekrutimi paraqitet: janar 7 punonjës, shkurt 11 punonjës, mars 2 punonjës, prill 3 punonjës, maj 4 punonjës dhe në gusht 1 punonjës. Pra struktura me 37 punonjës është plotësuar në muajin gusht. Procedurat e rekrutimit për pozicione të caktuara të punonjësve administrativ, janë përsëritur disa herë, për shkak të interesit të ulët (niveli i ulët i pagës) si dhe mosplotësimit të kriterëve të shpallura nga autoriteti përgjegjës për marrjen në punë, Komiteti Ad Hoc i Kolegjit të Apelimit. Vlen të theksohet se me aktin normativ nr.1, datë 26.07.2018, Kolegjit të Posaçëm të Apelimit ju shkurtua fondi i pagave me 10 milion lekë, nga 100 milion në 90 milion lekë. Sikundër kemi re latuar dhe në relacionin e fazës së dytë të PBA 2019-2021, ky shkurtim u krye në mënyrë arbitrare dhe pa u konsultuar me Kolegjin e Apelimit, veprim i cili cenon pavarësinë institucionale.

## **II - Shpenzimet për sigurime shoqërore (llogaria ekonomike 601)**

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore përbën 6% të buxhetit vjetor të miratuar me ligj për vitin 2018. Realizimi i fondit të sigurimeve si 8/mujor, kundrejt planifikimit 8/mujor është 72 % . Fondi i sigurimit është i lidhur me marrëdhëniet e punësimit, si rrjedhojë shkaqet e mosrealizimit të fondit të pagave vlejné dhe për këtë zë.

## **III - Shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime (llogaria ekonomike 602)**

Mallrat dhe shërbimet e planifikuara në këtë zë janë të domosdoshme për mbështetjen e realizimit të veprimtarisë institucionale. Ky grup shpenzimesh përbën 14% të buxhetit vjetor të miratuar me ligj për vitin 2018. Shpenzimet për llogarinë 602 (për mallra dhe shërbime) për 8/mujorin janë realizuar në vlerën 4,826,294 lekë dhe në përqindje në masën 35% të buxhetit të planifikuar. Në mënyrë analitike realizimi paraqitet në tabelën në vijim:

<b>Emërtimi</b>	<b>Realizimi 8/mujor (në lekë)</b>
<b>Materiale zyre dhe të përgjithshme</b> (kancelari, materiale pastrimi,, libra publikime profesionale,dokumentacion specific, uniforma etj)	<b>3,257,450</b>
<b>Të tjera materiale dhe shërbime speciale</b> (material të ndihmës së shpejtë)	<b>99,000</b>

<b>Shpenzime të tjera operative</b> (materiale marangozeri,,hidraulike, ndërtimi, shpenzime kompesimi pasaporta diplomatike,,qeramarrje foni boxer ,etj)	<b>85,310</b>
<b>Shpenzime për furnizimin me energji</b>	<b>925,674</b>
<b>Shpenzime për furnizimin me ujë</b>	<b>18,060</b>
<b>Posta dhe shërbim korrieri + abonim në shtypin e shkruar</b>	<b>35,415</b>
<b>Shpenzime telefonike</b>	<b>361,758</b>
<b>Shpenzime të tjera operative</b>	<b>43,627</b>
<b>TOTALI</b>	<b>4,826,294</b>

Realizimi, në masën 35% për zërin blerje mallra dhe shërbime është diktuar nga fakti se në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 518, datë 20.09.2017, Kolegji i Apelit është akomoduar në godinën e ish Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe ushtron veprimtarinë e tij jo nga fillimi i vitit, por nga muaji maj 2018.

-Në zërat “Shpenzime për energji elektrike” dhe “Shpenzime për furnizimin me ujë”, përkatësisht me vlerë 925,674 lekë dhe 18,060 lekë, janë pasqyruar shpenzimet për lidhjet e pikave dhe azhurnimet e rrjeteve për godinën e re të rikonstruktuar edhe konsumet e faturuara nga muaji maj e në vazhdim. Realizimi i tyre është në masën 50%, pasi planifikimi është bërë për 8-mujorin, ndërsa konsumi është realizuar për vetëm 4 muaj.

-Një pjesë e mirë e shpenzimeve në këtë zë si: materiale elektrike, shpenzime per karburant, vegla pune etj. janë prokuruar dhe likujduar në muajin shtator. Gjithashtu janë në proces prokurimi shpenzimet për libra dhe regjistra, kartëvizita, siguracion kasko për automjetin etj.

Nisur nga monitorimi dhe analiza e deritanishme e përdorimit të fondeve, është hartuar grafiku për ndjekjen me përparësi të zërave prioritar deri në fund të vitit, me qëllim plotësimin e nevojave për mallra dhe shërbime si dhe përdorimin me eficensë të buxhetit.

#### **IV. Investime kapitale**

Planifikimi i investimeve kapitale për vitin 2018, i detajuar sipas projekteve paraqitet:

000/lekë

<b>Kodi i projektit</b>	<b>Emërtimi i projektit</b>	<b>Plani i buxhetit viti 2018</b>	<b>Realizimi (8muajor / 2018)</b>
M630002	Blerje pajisje dhe mobilie zyre	5,000	0
M630013	Blerje pajisje elektronike	900	0
M630021	Softëare te menaxhimit të çështjeve	2,200	0

M630022	Softëare aktiviteti financiar	300	0
M630012	Sistemi audio- video sallë gjyqi dhe mbledhje	1,900	0
M630019	Pajisje scanner për kontroll, urë metali dedektor	12,700	0
M630020	Blerje automjeti për institucionin	3,000	2,555
<b>TOTALI</b>		<b>26,000</b>	<b>2,555</b>

Lidhur me ecurinë e investimeve në mënyrë të përmbledhur sipas projekteve rezulton:

-Ka përfunduar realizimi i blerjes së automjetit tip Fuoristradë 4x4, Model SSANGYONG KORANDO, në vlerë 2,554,000 lekë nga operatori ekonomik Albanian Motor Company. Prokurimi është realizuar me fond 446,000 lekë më pak se fondi limit.

- Përsa u përket skanerit dhe urës dedektor, është anuluar procedura e parë e prokurimit e kryer nga Ministria e Brendshme, pasi janë skualifikuar të 5-të Operatorët Ekonomik (OE) pjesëmarrës në procedure (për shkak të mosplotësimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të vlerësimit). Nga OE ka patur ankesa rreth procesit dhe pas shqyrtimit Komisioni i Prokurimit Publik është shprehur për rifillimin e procedurës. Mbas rishikimit të specifikimeve teknike, i përcollëm Ministrisë së Brendshme kërkesën për rizhvillim të procedurës. Data e hapjes së tenderit është 1 tetor 2018.

-Përsa i takon sistemit audio-video theksojmë se në kushtet kur sistemi video është dhuruar nga misioni OPDAT dhe është funksional, mbetet për tu prokuruar vetëm sistemi video. Buxheti i parashikuar në këtë zë, për vitin 2018, është 1,900 mijë lekë. Jemi në proces të zhvillimit të procedurave të prokurimit, për instalimin e sistemit video që do ti bashkëlidhet sistemit audio.

-Për programin e menaxhimit të çështjes gjyqësore, jemi në pritje të komunikimit me Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit për formalizimin e hartimit nga OSBE, të projektit teknik të përbashkët për të tre institucionet e vetingut.

-Sa i takon zërit Pajisje dhe mobilje zyre, ky zë është ndarë në Regjistrin e Parashikimit të Prokurimeve Publike në tre grupe, për plotësimin e nevojave për pajisje dhe mobilje për zyrat, blerje mjete dhe pajisje teknike si dhe blerje pajisje të ndryshme.

Procedura për prokurimin “Pajisje dhe mobilje”, është anuluar në muajin gusht për mosplotësim të dokumentacionit nga operatorët ekonomik. Eshtë rishpallur edhe një here dhe data e tenderit ishte përcaktuar 13 shtator. Gjatë kësaj periudhe është paraqitur ankesë nga një operator ekonomik, në lidhje me specifikimet teknike dhe mbas ezaurimit të hapave në lidhje me ankimin , nëse nuk do të paraqitet kjo ankesë në Komisionin e Prokurimeve Publike, tenderi do të hapet në datën 24 shtator 2018.

Me realizimin e këtij tenderi do të përmbushen nevojat dhe kërkesat në plotësim të blerjeve të kryera nga Ministria e Drejtësisë për institucionin tonë, në funksion të realizimit të objektivit për krijimin e kushteve optimale, për kryerjen e veprimtarisë institucionale.

Në dy zërat e tjerë të pajisjeve, për fondet që do të rezultojnë të lira, në përfundim të procedurave të prokurimit, do ti drejtohem Ministrisë së Financave, me kërkesën për rialokim të tyre për të mundësuar në këtë mënyrë realizimin e kërkesave dhe nevojave të tjera institucionale.